

GUIDË LIGJORE PRAKTIKE
MBI PUNËSIMIN DHE VETËPUNËSIMIN

“Employment Law Albania”

ZGJIDHJE LIGJORE PRAKTIKE DHE TË BESUESHME

PUNËSIMI

Përschëndetje, unë jam Tomi,dhe jam i punësuar



VEÇORITË E KONTRATËS SË PUNËSIMIT

- Lidhja që egziston midis Punëdhënësit dhe Punëmarrësit.

Sipas nenit 12 të Kodit të Punës (Kontrata e Punës),në kontratën e punësimit , punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e tij në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër të quajtur punëdhënës , i cili merr përsipër t'i paguajë një shpërblim(pagën).

Nisur nga ky përkufizim si dhe në interpretim të dispozitave përkatëse të Kodit të Punës,marrdhënia e punës karakterizohet nga fakti që punëdhënësi është ai që kontrollon ku, kur dhe si do të kryhet puna ,pra është detyrimi i punëdhënësit për të siguruar punën, vendin e punës dhe mjetet e punës për punëmarrësin ;

-Llojet e kontratave të punës

Kodi i Punës ,parashikon disa lloj kontratash: me kohë të pjesshme(part-time), me afat të caktuar, me afat të pacaktuar,kontrata e agjentit tregtar dhe kontrata e mësimit të profesionit.

PUNËSIMI

Mund të punohet nga shtëpia ose një vend tjetër i përcaktuar në marrëveshje me punëdhënësin (*kontrata e punës në shtëpi*) apo nëpërmjet teknologjisë së informacionit , në shtëpi ose në një vend tjetër të përcaktuar në marrëveshje me punëdhënësin (*kontrata e telepunës*).

-Shpërblimi ose paga

Paga është një element karakteristik dhe dallues i marrdhënies së punësimit .Ajo jepet sipas dispozitave përkatëse të kontratës kolektive ose individuale, nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e përcaktuar me vendim të këshillit të ministrave, paguhet vetëm nëpërmjet sistemit bankar dhe punëmarrësi vihet në dijeni për të gjithë elementet përbërës të saj si dhe shtesat dhe zbritjet që mbahen sipas ligjit.

-Tatimi mbi të ardhurat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore

Punëdhënësi është përgjegjës për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të parashikuara me ligj si dhe tatimin mbi të ardhurat.

-Elemente të tjera dalluese të kontratës së punës

Të tjera elemente dalluese të marrdhënies së punësimit janë detyrimi i punëmarrësit të kryejë personalisht punën e tij me përjashtim të rasteve kur mund të ketë rënë dakort ndryshe me marrëveshje; e drejta e punëmarrësit për pushime javore,pushim në ditët e festave zyrtare , pushimeve vjetore;e drejta e mbrojtjes nga largimi i padrejtë nga puna, e drejta e mbrojtjes nga diskriminimi, e drejta e shëndetit dhe sigurisë në punë, e drejta e shpërblimit për vjetërsi kur mardhëniet e punësimit kanë zgjatur më shumë se tre vjet dhe marrdhënia e punësimit ndërpritet nga punëdhënësi, etj

VETËPUNËSIMI

Përshëndetje, unë jam Xhoi dhe jam e vetëpunësuar

VEÇORITË E VETËPUNËSIMIT



Të vetëpunësuarit janë përgjegjës për rregjistrimin e aktivitetit të tyre dhe nxjerrjen e licensave dhe lejeve përkatëse sidomos kur objekt i aktivitetit të tyre është ofrimi i shërbimeve profesionale për të cilat kërkohet pajisja me licensa apo leje të vecanta të ushtrimit të profesionit si: shërbime juridike, në fushën e arkitekturës , inxhinierisë, mjeksisë etj.

Në ndryshim nga kontrata e punësimit ku punëdhënësi kontrollon ku, kur dhe si do të kryhet puna prej punëmarrësit, në rastin e të vetëpunësuarve, këta të fundit janë vetë përgjegjës për mënyrën dhe mjetet me të cilat do të realizojnë punën dhe përgjigjen vetëm për rezultatin e punës ndaj Klientit të tyre.

Kështu i vetëpunësuarit është vetë përgjegjës për vendin e kryerjes së punës, kohën e kryerjes së saj , mund të delegojë apo të nënkotrotojë një pjesë të punës , dhe e përcakton vetë shpërblimin për punën e tij sipas cmimit të negociuar me palën tjetër në një marrëveshje. I vetëpunësuarit është përgjegjës për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore si dhe taksave dhe tatimeve të tjera që mund të aplikohen sipas ligjeve në fuqi.

Kujdes: Ju mund të jeni i vetëpunësuar dhe të zgjidhni edhe të punësoheni. Ka rregulla të caktuara për llogaritjen dhe deklarimin e kontributeve për personin e vetëpunësuar, i cili njëkohësisht është edhe punëmarrës te një punëdhënës.

SHËNIM SQARUES

Sa më sipër është një informacion i përgjithshëm dhe praktik ,ai nuk është këshillim ligjor dhe nuk duhet trajtuar si i tillë. Informacioni ligjor i këtushëm duhet marrë ashtu sic është, pa asnjë përfaqësim apo garanci, të shprehur apo të nënkuptuar. Cdo kontratë pune apo e ngjashme ka specifikat e veta dhe informacioni i këtushëm nuk krijon një marrëdhënie konsulence juridike apo marrëdhënie avokat-klient. Employment Law Albania nuk mban përgjegjësi për pasojat e veprimeve që mund të kryeni apo vendimeve që mund të merrni duke u nisur nga ky postim. Nëse ju nevojitet këshillim ligjor na shkruani ne adresën e emailit: info@employmentlaw.al.

Ju falenderojmë për interesin tuaj.
Për më shumë informacione, Ju lutemi vizitoni
faqen tonë: www.employmentlaw.al
ose dërgoni email në: info@employmentlaw.al

Employment Law Albania
Zgjidhje Ligjore Praktike dhe të Besueshme